FEDERATA ESPORTS KOSOVA

Në bazë të nenit 5, paragrafët 2 dhe 3, nenit 6, paragrafët 2 dhe 8, si dhe nenit 7, pikat 12 dhe 13 të Statutit të Federatës Esports Kosova (FESK), pas shqyrtimit të propozimit lidhur me organizimin dhe ndarjen e çmimit të shpërblimeve (Prize Pool) për fituesit e Kampionatit Shtetëror Leauge of Legends 2026, Bordi i Federatës Esports Kosova, në mbledhjen e mbajtur më 02.05.2026, merr këtë:

V E N D I M

Neni 1
(Miratimi)

Miratohet propozimi për ndarjen e fondit të shpërblimeve (Prize Pool) për ekipin fituese të vendit të parë në Kampionatin Shtetëror për Seniot 2026, në kategoritë:

- **Leauge of Legends – Meshkuj;**

Neni 2
(Arsyetimi)

Gjatë periudhës 16–17 maj 2026, në Prishtinë në **Qendrën e Trajnimit FESK HUB** do të organizohet **Kampionati Shtetëror Leauge of Legends 2026**, me qëllim të zbulimit dhe zhvillimit të talenteve të rinj, si dhe masivizimit të lojërave elektronike (Esports) në Kosovë.

Federata parashikon që në këtë kampionat të marrin pjesë mbi 16 ekipe, me deri në 200 garues. Për të rritur motivimin e garuesve dhe për të promovuar zhvillimin e esports në Kosovë dhe në nivel evropian, është paraparë ndarja e shpërblimeve financiare për fituesit e vendit të par.

Bordi vlerëson se organizimi i këtij aktiviteti dhe ndarja e shpërblimeve financiare janë në interes të Federatës dhe në përputhje me Statutin e FESK-së.

Neni 3
(Miratimi i shpërblimeve)

Miratohet ndarja e fondit të shpërblimeve në këto vlera:

- **Vendi i parë – CS2 Meshkuj: 1000 euro**
- **5 lojtareve të ekipit fitues i ndahen nga 200 euro**

Vlera totale e fondit të shpërblimeve është 1,000 euro,

Neni 4
(Mënyra e pagesës)

Pagesa do të realizohet përmes transfertës bankare në llogaritë individuale të secilit lojtarë ë ekipit fitues.

Neni 5
(Zbatimi)

FEDERATA ESPORTS KOSOVA

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm dhe Zyra Financiare e Federatës Esports Kosova.

Neni 6
(Hyrja në fuqi)

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi i Federatës Esports Kosova.

